



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivered	17-08-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	№ Prot Br Prot Prot No	Shloje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/MSHCK	5700/2023		11.9



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.924/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare dhe Arben Mehmeti si dhe Eshref Shabani -anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.924/2023 të datës 06.07.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted], kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 16.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.924/2023, e datës 06.07.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 06.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5038/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 636/2012 të datës 27.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Akt emërimit Nr.636/2012 të datës 27.12.2022 lidhur me transferimin e saj për shkak të ristrukturimit të institucionit në pozitën "Zyrtare Administrative", në Departamentin për Shërbime, Gjoba dhe Ndëshkime Administrative për Pr. 1, 2 dhe 3, Divizioni i Shërbimit për T/P.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin



e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 12.07.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa me datën 13.07.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova;* Ankesën e ankueses [redacted] me numër protokolli 5038 të datës 06.07.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit të datës 01.04.2014 të [redacted] të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës; Akt emërimit me AE.Nr.636/2012 të datës 27.12.2022 të [redacted] për pozitën e punës "Zyrtare Administrative", në Departamentin për Shërbime, Gjoba dhe Ndëshkime Administrative për Pr. 1, 2 dhe 3, Divizioni i Shërbimit për T/P të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës; Formularin e përkrahimit të detyrave të punës për pozitën Zyrtar Administrativ; Kopjen e letërnjoftimit të [redacted] ID e punës të [redacted], Ekstraktin me numër serik E 25725953 të datës 18.11.2021 të lëshuar nga Regjistri i Gjendjes Civile të Republikës së Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Administratën Tatimore të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 688 të datës 13.07.2023 të Administratës Tatimore të Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 636/2012 të datës 27.12.2022, për transferimin e nëpunësit civil [redacted] për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, të Zv. Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Përkrahimi i punës për pozitën Nëpunës/Asistent Administrativ; Akt emërimit të [redacted] me numër protokolli 02/250/09 të datës 21.03.2014 të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022 të ankueses [redacted] të datës 31.12.2022; Struktura organizative e Administratës Tatimore të Kosovës e datës 04.10.2022; Përgjigjen e datës 16.08.2023/10:24, të Administratës Tatimore të Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 16.08.2023/9:06, të Administratës Tatimore të Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted], është e palejuar, sepse:

Ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 02/250/09 të datës 21.03.2014, ka qene e sistemuar në pozitën e punës "Zyrtare Administrative", në Departamentin e Shërbimit të Tatimpaguesve, mirëpo që për shkak të ristrukturimit në Administratën Tatimore të Kosovës Komisioni për Ristrukturim me rekomandimin me numër 7850 të datës 07.12.2022 ka rekomanduar transferimin e ankueses në pozitën „Zyrtare Administrative“ në Administratën Tatimore të Kosovës.

Me datë 27.12.2022 Zëvendësuesja e Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nxjerr Vendim me numër 636/2022 për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit respektivisht transferimin e ankueses në pozitën "Zyrtare Administrative" ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës në pajtim me Vendimin me numër 636/2022 të datës 27.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme ne me datë 27.12.2022 i ofron Akt emërimit me numër [redacted].Nr.636/2022 në pozitën "Zyrtare



*Administrative*", në Departamentin për Shërbime, Gjoha dhe Ndëshkime Administrative për Pr. 1, 2 dhe 3, Divizioni i Shërbimit për T/P.

Ankuesja me datë 06.07.2023 parashtron ankesën me numër të protokollit 5038 /2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor që Vendimi me numër 636/2022 të datës 27.12.2022 për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit dhe Akt emërimit me numër [redacted] Nr.636/2012 të datës 27.12.2022 të Administratës Tatimore të Kosovës, se janë nxjerr ne kundërshtim me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës ne ATK dhe aktet tjera të cilat rregullojnë fushën nga marrëdhënia e punës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 përcakton se: **"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"**, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshill është jashtë afati siç përcaktohet me nenin 127 paragrafi 1 të Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që ankuesja deklaron në ankesë se e njëjta ka qenë e njoftuar me përmbajtën e aktit të nxjerrë sepse Akt emërimit e ka pranuar me e-mail, andaj mbi këtë bazë nga momenti kur ankuesja është njoftuar me përmbajtën e aktit në fjalë kanë kaluar më shumë se 30 ditë, respektivisht ankesa e ankueses e datës 06.07.2023 me numër të protokollit 5038/2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në bazë të dëshmimeve të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit konkretisht përgjigjes së datës 16.08.2023 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, ka konstatuar se ankuesja Vendimin me numër 636/2012 të datës 27.12.2022 për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit të nxjerre nga Zëvendësuesja e Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB dhe Akt emërimit me numër [redacted] Nr.636/2012 të datës 27.12.2022 për pozitën e punës *"Zyrtare Administrative"*, në Departamentin për Shërbime, Gjoha dhe Ndëshkime Administrative për Pr. 1, 2 dhe 3, Divizioni i Shërbimit për T/P e ka pranuar me datën 27.01.2023, ndërsa ankesën me numër të protokollit 5038/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datë 06.07.2023 jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"**, prandaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji i Këshillit nga vlerësimi i provave ka konstatuar se përkundër faktit se me Vendimin me numër 636/2022 të datës 27.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme i është dhënë këshilla juridike se pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, ankuesja me asnjë provë nuk ka mundur të dëshmojë se e njëjta të këtë parashtruar ankesë





pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës ashtu siç është përcaktuar me nenin 24 të të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht Kolegji ka vlerësuar se ankuesja nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimimit brenda afatit prej *tridhjetë (30) ditëve* në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht Kolegji konstaton se momenti kur ankueses ka filluar ti rrjedhë afati ligjor për ankimim është nga data 27.01.2023 kur ankuesja e ka pranuar përmes e-mailit Vendimin me numër 636/2012 të datës 27.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB dhe Akt emërimin me numër Nr.636/2012 të datës 27.12.2022 për pozitën e punës "*Zyrtare Administrative*" andaj mbi këtë bazë Kolegji njëzëri konstaton se ankesa e ankueses është e pa lejuar.


Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.924/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.